



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS

01 Nr. 060/01-11638/2019

Datë. 25.04.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt të rregullt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2019, e mbajtur me datën 25.04.2019, me fillim në orën 10.00, në objektin e Komunës në Rr. “UÇK” në (ish objekti i BANKOS-it) **kati i –IV- Salla e Kuvendit të Komunës .**

Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Anton Shala .

Në mbledhje marrin pjesë 34 anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Haxhi Sejdiu, z. Nik Hyseni, z. Jusuf Osmani, z. Shaban Luma, znj. Teuta Pallaska-Milla, znj. Florentina Gjergjaj, znj. Albina Sadrija, z. Muharrem Musa, z. Basri Komoni, znj. Diana Qarkaxhija, znj. Hana Zeka, znj. Edi Puka, znj. Drita Buza-Zhaveli, z. Agon Batusha, znj. Mimoza Shala, znj. Lirika Komoni, z. Kreshnik Alijaj, z. Bekim Jupa, znj. Miranada Lushaj, znj. Dafina Sylja, z. Bashkim Gashaj, z. Sadik Hoti, znj. Saranda Hoda, z. Bekim Ermeni znj. Besarta Lekaj, z. Anton Shala, z. Zef Komani, znj. Arjeta Gjoklaj, z. Fazli Hoxha, znj. Valentina Alijaj, z. Edmond Dushi, z. Rrok Luli, z. Xhavit Alijaj

Mungojnë: Zef Komani

Të pranishëm të tjerë: Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Drejtorët e Drejtorive Komunale, përfaqësues të ZKKK-së, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal, si dhe përfaqësues nga mediat e shkruara dhe elektronike dhe qytetarë dhe zyrtar të tjerë të Komunës së Gjakovës.

Kryesuesi: I nderuar Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, i nderuar të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Drejtor të drejtorive Komunale, të nderuar përfaqësues të OSBE-së, të nderuar përfaqësues të Mediave, të nderur të Pranishëm .

Sot do ta kemi mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2019, Ju njoftoj se Kuvendi edhe për këtë mbledhje i ka 35 anëtarë, ndërsa prezent janë 34 anëtarë pritët për pak kohë të na bashkëngjitet anëtari i 35 z. Zef Komani i cili do të na bashkohet me vonë, ju njoftoj se komisioni qendror zgjedhor ka certifikuar dy anëtarë të ri të komunës të cilët sot janë prezent dhe para se të fillojmë rendin e ditës ftoj dy anëtarët e ri të bëjnë betimin z. Rrok Luli nga radhët e PDK-së si dhe z. Xhavit Alijaj nga radhët e AAK-së, të dy anëtarët e ri dhanë betimin, të dy anëtarëve të ri ju uruan mirëseardhje.

Rendin e ditës për këtë mbledhje e keni marrë së bashku me ftesën dhe materialin e mbledhjes sipas afateve të përcaktuara ligjore.

Kryesuesi: E qes në Votim miratimin e rendit të ditës sipas ftesës së bërë. Nga anëtarët e pranishëm e Kuvendit të Komunës **u votua kështu: 34 pro, 0 kundër , dhe te tjerët abstenuim .**
Pas votimit u miratua Ky :

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 28.03.2019.
2. Propozim vendim për rrimërimin e rrugës “Adriatik Alpet” dhe rrugës “7 Korriku 1998” me emrin e kongresmenit Amerikan “Eliot Engel”.
3. Propozim vendim për këmbimin e pronës komunale .
4. Informata e parë financiare e Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Mars 2019 .
5. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë 40.000€ K.F “ Vëllaznimi”.
6. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë 26.000€ Teatrit te Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë .
7. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë prej 4.000€ Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës .
8. Propozim-Vendimit për shpalljen e Interesit Publik për vazhdimin e rrugës tek banesat sociale.
9. Propozim-Vendimit për shpalljen e Interesit Publik për vazhdimin e Segmentit te rrugës “Muharrem Domi”
10. Raport për Ndrichimin Publik në Komunën e Gjakovës .
11. Raporti për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Gjakovës .
12. Të Ndryshme

1. Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.03.2019

Kryesuesi: Për këtë pik të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 28.03.2019 a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket këtij procesverballi .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime E qes në Votim miratimin e Procesverbalit pa vërejtjet.
Kush është: për, kundër, abstenuim.

Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës **Unanimisht u votua pro procesverballit** nga mbledhja e kaluar e mbajtur me dt. 28.03.2019 .

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Propozim vendim për rrimërimin e rrugës “Adriatik Alpet” dhe rrugës “7 Korriku 1998” me emrin e kongresmenit Amerikan “Eliot Engel”.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Propozim Vendimit për rrimërimin e rrugës “Adriatik Alpet” dhe rrugës “7 Korriku 1998” me emrin e kongresmenit Amerikan “Eliot Engel”, andaj e ftoj Kryetarin e Komunës z. Ardian Gjini që ta merr fjalën .

Kryetari : Për këtë pikë theksoj se para disa kohe kam zhvilluar një takim me Kryetarin e Bashkisë Tropojë për një iniciativë për emërtimin e një rruge që kalon në dy shtetet tona ideja është që edhe rruga në anën tonë të emërohet me emrin e kongresmenit “Eliot Engel” bashkia Tropojë e ka kryer këtë emërtim, mendoj që për kongresistin “Eliot Engel” nuk ka nevojë shume fjalë për shkak se dihet kontributi i tij për Shqiptarë posaçërisht në Kosovë, kështu që unë kërkoj nga asambleistët që ta miratojnë këtë vendim, i kemi dy rrugë të

cilat janë të emërtuara tani qe do të ndërrohet emri është rruga “Adriatik alpet” dhe “7 Korriku 1998” sidoqoftë ne do të gjejmë vend për këto rrugë që ti fusim në kod sidomos për “7 korriku 1998” për të cilën kemi biseduar.

Kryesuesi: E hapë diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

znj. Mimoza Shala: Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës shprehim mbështetjen e subjektit LVV, njëkohësisht shprehë shqetësimin lidhur me kërkesat për emërtimet e rrugëve për shkak se asambleja është pajtuar por këto kërkesa nuk janë marrë parasysh andaj ju lutem na tregoni se cilat janë procedurat të cilat duhet ti ndjekim për ti bërë riemërtimet që kemi kërkuar.

Kryetari : Nuk jam në dijeni sepse kur vjen një propozim asambleja i kalon dhe jo ekzekutivi këto janë çështje të asamblesë dhe në momentin që kalojnë në votim në asamble sepse ekzistojnë disa procedura janë kodet duhet me hy edhe në harta elektronike ndërkombëtare është më e komplikuar se në të kaluarën, mirëpo vendimet e asamblesë janë definitive, unë nuk po di nëse dikush din të sqarohet për këtë temë.

Kryesuesi: Mimoza po sqarohem është e vërtetë se keni shumë kërkesa lidhur me emërtimin e rrugës ju e dini se një komision i cili ka qenë më herët nëse Kuvendi i Komunës pajtohet me filluar edhe një herë me shqyrtimin e kërkesave për riemërim të rrugëve atëherë është çështje e jona që duhet të vendosim por duhet të kemi parasysh se shpeshherë ka kërkesa të pa justifikuara mirë dhe ndodh, ne si Kuvend të biem në lajthitje para se ta kemi komisionin komunal për këto çështje i cili do të bashkëpunon me drejtorinë për urbanizëm i cili do të kujdeset për kërkesën tuaj.

znj.Mimoza Shala : Në rregull ne do ta nisim kërkesën edhe me shkrim bëhet fjale për Pashke Marku dhe Aziz Daci ku kemi kërkuar të emërohet një rrugë por familja dhe lagjja kanë kërkuar që një park i vogël në lagjen e tyre i cili quhet “rinia” të zëvendësohet me emrin “Aziz Daci” ndërsa për “Pashke Marku” të zëvendësohet rruga me emrin “Uashingtoni”.

Kryetari : Qëllimi i emërtimit të rrugëve është edhe kushti i liberalizimit të vizave prandaj duhet të kemi kujdes në këtë aspekt sepse shumë herë ka ndodh që të kemi probleme lidhur me adresën e saktë të ndonjë individi të caktuar qoftë për ndonjë vepër penale apo edhe ndonjë rast tjetër prandaj është komplikuar procedura e ndërrimit të emrave, prandaj unë mendoj se propozimi është i mirë dhe duhet të gjejmë zgjidhje.

z.Haxhi Sejdiu : Lidhur me tërheqjen e emrit të rrugës “ 7 korriku 1998” ndoshta e dini çfarë rëndësie ka ai emër sepse ky emër i kushtohet një beteje shumë të fortë të zhvilluar në Morinë nga radhët e UCK-së kundër forcave serbe ku në atë beteje kemi dëshmore prandaj duhet të kemi kujdes lidhur me emërtimet e rrugëve.

Kryesuesi : Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, propozim-vendimin për riemërimin e rrugës “Adriatik Alpet” dhe rrugës “7 Korriku 1998” me emrin e kongresmenit Amerikan “Eliot Engel **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 33, kundër 0 abstenim 1** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe Plotësohet vendimi 01nr.011-51211/14 i datës 27.11.2014, për miratimin e listës për emërtimin e rrugëve

2. Rrugët me emër “Adriatik Alpet” me kod nr.10796 dhe rruga “7 Korriku 1998” me kod nr. 10808 të marrin një kod dhe të riemërohen me emrin e kongresmenit Amerikan “Eliot Engel”.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Propozim vendim për këmbimin e pronës komunale .

Kryesuesi: Propozim vendim për këmbimin e pronës komunale bëhet fjalë për ndërtimin e 5 shtëpive në fshatin Netic për komunitetin pakicë.

Kryetari: Fshati Netic është një fshat ku banojnë komuniteti pakicë ata banorë nuk janë pronarë të tokës ku jetojnë unë i kam vizituar ndërsa gjendja e tyre është jashtëzakonisht e mjerueshme, komuniteti i asaj zone kanë arritur të gjejnë donatorë i cili do ti ndërtojë 5 shtëpi për këta banorë, vlen të ceket se Muharrem Musa e ka udhëhequr këtë proces, ndërsa nga Kuvendi i Komunës pritet me ju nda troja të vogla për ti ndërtuar disa shtëpi modeste për ata banorë, me qenë se Kuvendi Komunal nuk ka pasur pronë të përshtatshme për këtë arsye jemi detyruar me hy në këmbim me Agjencinë Pyjore të Kosovës, i keni gjitha materialet e nevojshme prandaj kërkojë nga ju që ta votoni.

znj. Diana Qarkagjia : Sa i përket pikës së rendit të ditës për fshatin Netic, kemi vizituar më shumë se 4 herë në qeverisjen e kaluar kemi provuar përmes Drejtorisë së Arsimit dhe disa mjeteve shtesë ti ndihmojmë ata fëmijë ju kemi siguruar dhe transportin, por duhet të them se në atë lagje janë më shumë se 5 shtëpi prandaj me intereson të dijë se me qfarë kriteri janë përcaktuar familjet përfituese.

z. Muharrem Musa : Ju njoftojë se nuk janë 5 shtëpi por 8, për 3 shtëpi tjera donatori ka vendos të i ndërtoj në Brekoc ndërsa për këto familjet tjera janë pajtuar të zhvendosen andaj kërkojë nga ju që ta përkrahni këtë vullnet të mirë të donatorit.

Kryesuesi : Nëse nuk ka diskutime tjera atëherë e qes në votim propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen e interesit publik në pronën e Agjencinë Pyjore të Kosovës me qëllim të këmbimit të pronës komunale sipas të dhënave të propozuara në propozim-vendim të kryetarit, **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 34, kundër 0 abstenim 0** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për shpalljen e interesit publik, dhe këmbimin e pronës komunale me numër kadastral P-707050390-00380-1, me pronën e Agjencionit Pyjor me numër kadastral P-70705039-00021-1.
2. Parcela me numër P-707050390-00380-1 Z.K Gjakovë J. Qytet, me sipërfaqe totale prej 38090 m², në pronësi të P.SH. Kuvendi i Komunës Gjakovë të këmbëhet me pronën me numër P-70705039-00021-1 Z.K Gjakovë J Qytet në pronësi të Agjencionit Pyjor në sipërfaqe prej 391182 m².

3. Këmbimi i pronave të lartcekura në piken 1 dhe 2 të këtij Propozim Vendimi bëhet me qëllim që të ndërtohen 5 shtëpi për 5 familjet të Komuniteteve pakicë që jetojnë në fshatin Netic dhe nuk posedojnë prona të tyre .
4. Këmbimi do të behët sipas vlerës së caktuar nga Komisioni për Vlerësimin e Pronës dhe vlera do të llogaritet sipas çmimit të tregut.
5. Obligohen organet e administratës komunale që të zbatojnë procedurat ligjore për këmbimin e pronës komunale sipas pikës 1 dhe 2 të këtij propozim vendimi komfört Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Pika e katërt e rendit të ditës: Informata e parë financiare e Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Mars 2019 .

z. Durim Halilaj: Kjo informatë ka për qëllim të tregojë gjendjen financiare të komunës për vitin 2019 planifikimin për realizimin e të hyrave, alokimit të mjeteve, shpenzimit të tyre dhe ato në kategoritë ekonomike si dhe të gjithë treguesit tjerë relevant, buxheti për vitin fiskal 2019 është 25.093.172 € gjatë kësaj kohe mjete të alokuara për komunën e Gjakovës janë 7.106.329 ndërsa janë shpenzuar 4.732.343 € apo 68% e mjeteve të alokuara në paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione, si dhe shpenzime kapitale.

Kryesuesi : E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z. Bekim Ermeni : Me duhet të them sipas raportit shohim se investime kapitale kemi 8.5% dhe subvencione rreth 5% e cila është një shifër shumë e vogël, kemi diskutuar po ashtu për shpenzimet analitike kemi kërkuar sqarime në KPF, po ashtu kërkoje të jemi me të vetëdijshëm për zbatim me të mirë të buxhetit.

z. Agon Batusha : Ato që u thanë nga parafolësi im i kemi diskutuar edhe në KPF ku kemi thënë se mbledhjet e KPF-së nuk përcillen drejtpërdrejt dhe ne duhet të cekim disa gjera që për opinionin të jenë të qarta në detaje. Vlen të ceket se të hyrat nga tregjet prapë edhe këtë vit kemi më shumë të hyra nga tregjet se sa ato që i kemi planifikuar. Pra jeni në dijeni se vitin e kaluar kemi pasur keq planifikim pasi që është rritur 300.4% , po ashtu dënimet në trafik kanë kaluar prej 250.000 € në 550.000 € por ne po i lejojmë prapë dënimet me të vogla në trafik që mbraja me na u kompensuar neve dhe drejtoritë apo komunën, pasi që në shumicën e zërave buxhetor kur dalin negativ pastaj ne dënime në trafik me dal pozitiv, 121.429 € janë inkasua për 3 muaj ndërsa planifikimi ka qenë 54.500 € që do të thotë i kemi 222% më shumë inkasim, pra kjo është duke ndodhur çdo vit. Këtu ka edhe shumë zëra buxhetor ku ka tejkalime të vogla të cilat janë pozitive për komunën, por ka edhe shumë tjera që nuk janë plotësuar në masën e duhur. Kur jemi tek drekat zyrtare është mirë të sqarohet për opinionin, ku 12.000 mijë euro janë shpenzuar këtë vit për dreka zyrtare pra është 153% më shumë, që i bjen përafërsisht 205 euro në ditë. Tek shpenzimet në investime kapitale ka alokim dikur rreth 20 apo 30% e mjeteve që janë paraparë, por kur ti shikojmë projektet shumica e projekteve nuk kanë alokim 100% pra për këtë nuk po përfundojnë gjitha projektet në kohë pasi që nuk janë alokuar gjitha mjetet e projekteve.

znj. Diana Qarkagjia : Do të doja të diskutoja lidhur me të hyrat vetanake që janë 85% brenda këtij 3 muaji po ashtu shpenzimet buxhetore për vitin 2019 janë rritur sipas kësaj i bie që 71% të hyrave nga niveli komunal shkojnë komplet në paga po ashtu shpenzime tjera janë për dreka zyrtare po ashtu sa i përket

subvencioneve jam e shqetësuar sepse ka shumë njerëz që kërkojnë subvencione kurse të shpenzuara janë rreth 1% e mjeteve totale që i disponon Komuna e Gjakovës

znj. Florentina Gjergjaj : Dua ti diskutoj disa nga kritikrat që u ceken nga parafolësit e mijë lidhur me kontratat mbi vepër, furnizimin me material të punës si dhe kompjuter, gjitha këto keni pasur mundësi ti diskutoni në KPF por keni hesht sidomos sa i përket çështjes se kontratatave mbi vepër andaj nuk po me duket e arsyeshme të diskutohet këtu.

z. Edmond Dushi : Qasja ime ndaj këtij raporti është me ndryshe për shkak se shpenzimet dhe alokimet mund të variojnë dhe në fund të vitit mund të përputhen me planifikimin, në raport me planifikimin periodik kemi shpërputhje të madhe në disa drejtori, në Drejtorinë për Urbanizëm kemi 31% ndërsa në drejtoritë tjera janë tejkaluar. Tek mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 35.6% duke e ditur për kontratën që e kemi diskutuar në njërin prej seancave, ku e kemi cekur se një kontratë për mirëmbajtje të automjeteve ka qenë nga një kompani nga Prizreni dhe e kemi diskutuar se një autolarje kushton 8 euro një litër vaj kushton 20 e kështu me radhë, atëherë një sqarim pse është zvogëluar kjo shifër, a nuk janë duke u mirëmbajtur automjetet apo është ndryshuar kontrata. Pra presim një sqarim.

z. Durim Halilaj : Sa i përket investimeve kapitale duhet te them se jemi ne periudhën e pare për shkak gjitha njësit e kërkesave i kanë në prokurim për shkak për ti hapur tenderët dhe shpenzuesmëria kapitale vazhdon në tremujoin e dytë të tretë dhe në tremujorin e katërt vërehen shpenzueshmëritë . Nëse i shohim vitet e kaluara 2016, 2017 shpenzueshmëria e buxhetit ka qenë 73% ndërsa ne vitin e kaluar 2018 e kemi shpenzuar 82% ndërsa në këtë vit synojmë shifrën 90%.

Kryetari : Nëse e shohim buxhetin e miratuar me herët dhe alokimit deri ne qershor te vitit te kaluar për Komunën e Gjakovës realizimi ka qene 93% , në vitin 2017 Komuna e Gjakovës ka realizuar 5.100.000 € prokurim ndërsa në vitin 2018 ka realizuar 11.000.000 € prokurim e njëjta administratë pa asnjë ndryshim këtu vërehet se ka pas investime serioze kapitale atëherë un vetëm mund ti përgëzoj për punën e tyre këtë vit Komuna e Gjakovës planifikon ti tenderojë mbi 22.000.000 € nëse i shikoni dallimet me vitet e kaluara e vëreni se kjo administratë është duke prokuruar me shumë se çdo herë tjetër nuk janë vetëm fjale por eksitojnë projekte dhe dokumente për gjitha këto po ashtu e keni edhe buxhetin. Edhe një gjë tjetër për fund raporti në mes të buxhetit komunal dhe shpenzimeve kapitale është tepër i rëndësishëm për zhvillim komunal për herë të parë ka dal mbi 30% dhe do të vazhdojë të rritet.

Pika e pestë e rendit të ditës : Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë prej 40.000€ për KFC “ Vëllaznimi“.

Kryesuesi : hapi diskutimin fillimisht fjalën ja japim drejtoreshës për sqarime pastaj fillojmë me diskutime.

znj. Saranda Hyseni : Para jush sot i keni 3 pika nga drejtoria për kulturë rini dhe sport po fillojmë me kërkesën e klubit futbollistik Vëllaznimi po ashtu edhe raporti te cilin e keni kërkuar nga vet klubi, kërkesa e K.F Vëllaznimi ka qenë në vlerë prej 50.000 € për shkak të vështirësive të cilat po kalon ky klub tash e sa kohë po ashtu vlerën qe ka ky klub tek qytetarët e Gjakovës atëherë Komuna e Gjakovës si dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ka qenë e obliguar për ta mbështetur klubin edhe këtë vit edhe për kundër vështirësive dhe kërkesave te shumta ne kemi arritur te i'u sigurojmë një shume te konsiderueshme pata jush i keni të gjitha dokumentet e nevojshme qe Vëllaznimi ta ketë ketë shumë kërkohet miratimi juaj.

znj. Drita Buza: Me datën 9 shkurt 2018 K.F Vëllaznimi ka paraqitur kërkesë për subvencion në vlerë prej 45.000 € dhe ja kemi aprovuar, afërsisht pas 13 muajve ka kërkuar prapë subvencion në vlerë prej 40.000 euro, pra për nuk e di a keni krahasuar kërkesën e vitit 2018 dhe atë të vitit 2019 janë identike, nuk kam asgjë kundër subvencioneve për vëllazninimin, mirëpo shqetësimi im është se nuk e kemi vetëm një sport por kemi

edhe sporte tjera si hendbolli, basketbolli, ping-pongi, bjeshkatarët, shahistët etj, prandaj unë sugjeroj që ky buxhet të participohet edhe tek sportet tjera.

z. Edmond Dushi : Jemi të vetëdijshëm se K.F Vëllaznimi edhe vitin e kaluar ka kërkuar subvencion prej 45.000 € të cilin e kemi miratuar, mirëpo ato që u përmenden nga znj. Buza se kërkesa e klubit është përsëritje, mendoj se është e vërtetë, prandaj komisioni besoj ia ka miratuar dhe ka kërkuar nga ne që ta miratojmë 10.000 € me pak sepse kërkesa ka qenë 50.000 €, po ashtu duhet të jemi të vetëdijshëm se një ekipi futbollistik që është cekur edhe në raportin e klubit të cilin e morëm sot për vitin e kaluar nevojitet afërsisht mbi 200.000 € andaj ne e dimë se statusi i klubit nuk është i rregulluar ashtu siç ne kemi dëshirë prandaj shpresoj se shume shpejt do ta kenë që klubi të shndërrohet në shoqëri aksionare, por unë jam i pajtimit që të miratohet kërkesa e tyre.

z. Shpend Kumnova : Mendoj se kërkesa e K.F Vëllaznimi është e arsyeshme dhe e pranueshme sa i përket listimit të kërkesave nga ana e klubit nuk mendoj se janë problem por unë mendoj se buxheti i ceket i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport është problem për shkak se duke përkrah një klub atëherë po diskriminohen klubet tjera unë mendoj se ky problem duhet zgjidhur duke i shndërruar këto klube në shoqëri aksionare që këto klube të ju ofrohen sektorit privat sepse do të kenë qëndrueshmëri me te mirë për ndryshe çdo ditë do të përballemi me këso kërkesa vetë në këtë formë do të kemi zgjidhje afatgjate për sportin.

z. Bekim Ermeni : Ne si LDK e mbështesim këtë kërkesë për K.F Vëllaznimi, por ajo çka është e paqartë e kemi diskutuar edhe në KPF, cila është përgjegjësia jonë si anëtarë të kuvendit për të marrë vendime për subvencione për shkak se rregullorja nuk e përcakton se për cilat raste duhet miratimi i kuvendit por vetëm për vlera mbi 15.000 €, sot ne kemi edhe kërkesën e klubit të hendbollit Shqiponja për shkak se i keni futur në lajthitje klubet që ata të na drejtohen neve, e cila është gabim po ashtu edhe pika e rendit të ditës është gabim sepse duhet të ishte a mbështetni kërkesën që K.F Vëllaznimi të subvencionohet në vlerë me shume se 15.000 €.

z. Haxhi Sejdiu : Sa i përket subvencioneve kemi të bëjmë me ekipin e hendbollit para disa dite kemi pasur takimin e KPF-së unë kom iniciuar kërkesën me vetiniciativë që të aprovohet një shumë e parashtruar vitin e kaluar nga klubi hendbollit Shqiponja me arsyetimin se ai klub dhe ato vajza kanë arritur suksese në vitet 2017-2018 ne si qytet i Gjakovës meritojnë për ti shpërblyer ato vajza me një donacion po ashtu ju njoftojë se kemi marrë mbështetjen nga ana kryetarit që të ndihmohet ky klub.

Kryetari : E kuptojmë se këto situata nuk janë të lehta por ideja e subvencionimit është për ta stimuluar sportin artin por edhe biznesin nëse ne i kishim hequr subvencionet atëherë kishim rrezikuar të shuheshin këto klube ose shumica prej tyre , duhet ta keni parasysh se shuarja e klubeve nuk është vetëm shuarje e pasionit të tifozëve është edhe cenim i mundësive të rinjve për tu marr me sport, prandaj do të mundohemi ti mbështesim edhe klubet tjera në mënyra të ndryshme.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, propozim –vendimin për ndarjen e Subvencioneve në vlerë 40.000 € për K.F “ Vëllaznimi“. **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 34, kundër 0 abstenim 0** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 40,000,00€ për Klubin e Futbollit K.F “Vëllaznimi” nga Gjakova, për vitin 2019 .

2. Mjetet financiare në vlerë prej 40,000.00€ të mirën nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport, dhe të derdhen në xhirollogarinë e Klubit Futbollistik K.F “Vëllaznimi” .
3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e veprimtarisë Sportive të K.F “Vëllaznimi” në Gjakovë në bazë të kërkesave për mbështetje financiare për vitin 2019 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Pika e gjashtë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë prej 26.000€ Teatrit te Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë .

Kryesuesi : hapi diskutimin fillimisht fjalën ja japim drejtoreshës për sqarime pastaj fillojmë me diskutime lidhur me piken e gjashtë të rendit të ditës Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë prej 26.000€ Teatrit te Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë .

znj. Saranda Hyseni : Vlen të theksoj se Teatri “Hadi Shehu” përpos subvencioneve nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, subvencionohet edhe nga Ministria për Kulturë si dhe donacionet e ndryshme për ndryshe kish me qen e pamundur vetëm me buxhet të drejtorisë të realizohet reportuari i Teatrit po ashtu jeni në dijeni se teatri është duke përgatitur realizimin e dy premierave për këtë arsye dua të falënderoj aktorë gjithë stafin dhe organizatorët për punë dhe angazhimin e tyre andaj kërkojë nga ana juaj qe ky propozim-vendim të miratohet.

znj. Drita Buza : Në kuadër te aktiviteteve kulturore a keni menduar të ndani buxhet për festivalin e fëmijëve që është një aktivitet 23 vjeçar po ashtu aktivitetin tjetër fëmijët ne skenë i cili është një teatër amator ku përfshihen gjitha shkollat si cikël i ulët ku pastaj ne i zbulojmë talentet e rijnë, ne i japim një shumë prej 40.000 € një klubi i cili nuk tregon rezultate vitin e kaluar dhe tifozët nuk janë ndarë të kënaqur, prandaj duhet te jeni me te kujdesshëm kur jepen subvencione.

Znj. Saranda Hyseni : I mbaj mend shifrat të cilat janë ndarë për teatrin për shkak se para se te jem drejtoresh kam qene anëtare e kuvendit dhe mund te them se nuk ka regres por progres çdo vit, prej 6 aplikacioneve që kanë qenë vitin e kaluar ketë vit i kemi 17 aplikacione të kulturës për të cilat komisioni ka nda subvencione prandaj nuk mund të thoni se nuk janë mbështetur aktivitetet kulturore përpos klubit K.F Vëllaznimi ne kemi edhe 37 klube tjera qe janë mbështetur financiarisht.

z. Edmond Dushi : Njëjte si ne piken paraprake ne jemi duke votuar kërkesën e drejtorisë për kulture rini dhe sport e cila ka ardhur si rezultat i komisionit për ndarjen e subvencioneve qe ka vlerëso shumen te cilën sot neve na kërkohet ta votojmë, edhe pse shuma e ndarë nga komisioni është e vogël ne do ta përkrahim.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, propozim –vendimin për ndarjen e subvencioneve ne vlerë prej 26.000€ Teatrit te Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë. **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 34, kundër 0 abstenim 0** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 26,000,00€ për Teatrin e Qytetit “ Hadi Shehu në Gjakovë, për vitin 2019 .

2. Mjetet financiare në vlerë prej 26,000.00€ të mirën nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport .
3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e programit të Teatrit të Qytetit “ Hadi Shehu në Gjakovë ” në bazë të kërkesave nga Plani vjetor për vitin 2019 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Pika e shtatë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve ne vlerë prej 4.000€ Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës .

Kryesuesi : hapi diskutimin fillimisht fjalën ja japim drejtoreshës për sqarime pastaj fillojmë me diskutime lidhur me piken e shtatë të rendit të ditës.

Znj. Saranda Hyseni : Në dokumentacionin te cilin e keni marr ne mbledhjen e asamblesë komunale e keni vendimin e datës 26.07.2013 ka qenë propozimi i kryetarit të komunës për formimin e ansamblit muzikor te komunës se Gjakovës i cili për një kohe te gjate ka vepruar formalisht asnjëherë nuk ka pasur ndonjë buxhet te ndarë për aktivitete të këtij ansambli, në fund vit keni pasur mundësin ta shifni një performancë shumë të mirë po nga ky ansambël, ndërsa për këtë vit ky ansambël ka paraparë ti mbajë dy evente, njëri do të jetë ky për të cilin ne do të votojmë vlere prej 4.000 € ka të bëjë me organizimin e koncertit festiv për nder të 14 qershorit pra 20 vjetorit të çlirimit të Gjakovës kjo ka qenë mundësia buxhetore e jona sepse ne ketë orkestër ka edhe instrumentist nga filarmonia e Kosovës.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, propozim –vendimin për ndarjen e subvencioneve ne vlerë prej 4.000 € Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës . **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 34, kundër 0 abstenim 0** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 4.000€ Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës, për vitin 2019 .
2. Mjetet financiare në vlerë prej 4.000€ të mirën nga kategoria e subvencioneve në buxhetin e Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport .
3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e programit të Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës në bazë të kërkesave nga Plan projekti për Koncertet për vitin 2019 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

Pika e tetë e rendit të ditës : Propozim-Vendimit për shpalljen e Interesit Publik për vazhdimin e rrugës tek banesat Sociale.

Kryesuesi : hapi diskutimin lidhur me pikën e tetë të rendit të ditës fillimisht fjalën ja japim drejtoreshës për kadastrë Afërdita Lama.

Znj. Afërdita Lama : Drejtorja për Kadastrë Gjeodezi dhe Pronë duke u bazuar në nenin 12 të ligjit 03L040 për vetëqeverisjen lokale dhe paragrafi 1 lidhur me nenin 3 dhe 4 të ligjit 03L139 për shpronësimin e pronës se paluajtshme për ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjin L205 lidhur me shqyrtimin për shpalljen e interesit publik për vazhdimin e segmentit të rrugës te banesat sociale kërkon nga kuvendi komunës që të miratojë këtë propozim-vendim për shpalljen e interesit publik, shpallet interesi publik në gatrat kadastrale për pjesët e tyre me numër 5077/7 , 507711 507710 57710 të gjitha ne zonën kadastrale jashtë-qytet qëllimi i shpalljes se interesit publik për gastren si arsyeshmëri për gastrat e theksuara ne piken 1 të këtij propozim-vendimi është që te njëjtat te shpronësohen respektivisht pjesët e tyre për vazhdimin e segmentit te rrugës te banesat sociale për arsye se rruga ekzistuese që është tani ajo është prone private dhe sipas planit urbanistik aty do te filloje ndërtimi, procedura e shpronësimit do te zhvillohet sipas ligjit për shpronësim siç është theksuar ne pjesën hyrëse te këtij vendimi çështja është për një rruga e cila ka gjerësinë 27 metra gjatësia e kësaj rruge është 241 metër sipërfaqja për shpronësim është gjithsejtë 32.8 ari e gjitha kjo është sipas planit rregulativ të urbanizmit.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, propozim –vendimin për ndarjen e subvencioneve ne vlerë prej 4.000 € Ansamblit Muzikor të Komunës së Gjakovës . **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 34, kundër 0 abstenim 0** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V e n d i m
Për
Shpalljen e interesit publik .

- 1.Shpallet Interesi Publik në pjesët e ngastrave Kadastrale me nr.5077-7, nr. 5077-11, nr. 5077-10, nr. 5771-0 Z.K. Gjakovë-J. Qytet
- 2.Qëllimi i shpalljes së Interesit Publik në pjesët e parcelave të përshkruara në pikën 1 të këtij vendimi është vazhdimi i procedurave të Shpronësimit për vazhdimin e ndërtimit të segmenti të rrugës tek Banesat Sociale .
- 3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista me të dhënat e pronave në të cilat do të Zhvillohen procedurat e Shpronësimit sipas Interesit Publik për ndërtimin e segmenti të rrugës tek Banesat Sociale .
- 4.Autorizohen organet e Administratës Komunale që ti zhvillojnë të gjitha procedurat e parapara ligjore për realizimin e këtij vendimi .
- 5.Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës .

Pika e nëntë e rendit të ditës : Propozim-Vendimit për shpalljen e Interesit Publik për vazhdimin e Segmentit të rrugës “Muharrem Domi”

Kryesuesi : : hapi diskutimin lidhur me pikën e nëntë të rendit të ditës fillimisht fjalën ja japim drejtoreshës për kadastër Afërdita Lama.

znj. Afërdita Lama : Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, duke u bazuar në nenin 12 të ligjit L-0340 të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe paragrafin 1 lidhur me nenin 3 dhe 4 të ligjit 03-L/139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme me plotësimet dhe ndryshimet e bëra të ligjit 03-L/205 lidhur me shpalljen e Interesit publik për vazhdimin e Segmentit të rrugës “Muharrem Domi” kërkon nga Kuvendi Komunës të miratojë këtë propozim vendim.

Shpallet interesi publik në gastrat kadastrale me numër 5314-2, 5314-1, 4304-1, 4317-1, 4306 të gjitha në zonën kadastrale Gjakovë jashtë-qytet dhe në gastrat 1359-0, 1236-6, 1236-5, 1236-26, 1236-27, 1236-25, 1238-0, të gjitha në zonën kadastrale Jahoc arsyeshmëria e këtij propozimi është qëllimi i shpalljes së interesit publik të gastrave të theksuara në pikën 1 të këtij propozim-vendimi të njëjtat të shpronësohen respektivisht pjesët e tyre për vazhdimin e segmentit të rrugës “Muharrem Domi” procedura e shpronësimit do të zhvillohet sipas ligjit për shpronësim siç është e theksuar në pikën hyrëse të këtij propozimi gjatësia e kësaj trase do të jetë 10 metra gjatësia është afër 700 metër, dhe sipërfaqja për shpronësim do të jetë 75 ari.

z. Zef Komani : Çdo hapje e rrugës është shenjë e mirëfilltë e një zhvillimi pa marrë parasysh i komunës apo shtetit, mirëpo qytetarët kanë pyetje e cila është e rëndësishme për ta që ka të bëjë lidhur me shpronësimet se kur kompensohen qytetarët, sepse kam obligim nga 3 qytetarë të ju pyes lidhur me këtë temë me që jemi në këtë pikë të rendit të ditës, pra ka rast që është shpronësuar që 1 vit e gjysmë dhe ende nuk është kompensuar dhe kam dëshirë ta di për hire të qytetarë ta dimë sa zgjatë procedura e shpronësimit dhe kompensimit.

Kryetari : Janë procedura të rregulluara me ligj pagesat e shpronësimit zgjasin me se hershmi momentin kur kryhet vendimi përfundimtar dhe ka buxhet dhe me se largu 2 vite prej datës së vendimit përfundimtar.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime, e qes në votim, propozim –vendimin për shpalljen e Interesit Publik për vazhdimin e Segmentit të rrugës “Muharrem Domi” **kush është për, kundër, abstenim.** Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit të Komunës u votua **pro 34, kundër 0 abstenim 0** . Pas votimit të bërë Kuvendi e miratoi këtë :

V e n d i m **Për** **Shpalljen e interesit publik .**

- 1.Shpallet Interesi Publik në pjesët e gastrave Kadastrale me nr.5314-2, nr.5314-1, nr.4304-1, nr.4317-1, nr.4306 ZK Gjakovë J. qytet dhe në gastrat 1359-0 , nr. 1236-6 nr. 1236-5, nr. 1236-26, nr. 1236-27, nr.1236-25, nr.1238-0 ZK Jahoc .
- 2.Qëllimi i shpalljes së Interesit Publik në pjesët e parcelave të përshkruara në pikën 1 të këtij vendimi është vazhdimi i procedurave të Shpronësimit për vazhdimin e ndërtimit të rrugës “ Muharrem Domi “ .
- 3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista me të dhënat e pronave në të cilat do të Zhvillohen procedurat e Shpronësimit sipas Interesit Publik për ndërtimin e rrugës “ Muharrem Domi .

4. Autorizohen organet e Administratës Komunale që ti zhvillojnë të gjitha procedurat e parapara ligjore për realizimin e këtij vendimi .

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës .

Pika e dhjetë e rendit të ditës : Raport për Ndriçimin Publik në Komunën e Gjakovës .

Kryesuesi: hapi diskutimin lidhur me pikën e dhjetë të rendit të ditës fillimisht fjalën ja japim drejtorit për shërbime publike Shkumbim Kastrati.

z. Shkumbim Kastrati : Sa i përket këtij raporti e kam prezantuar edhe ne KPF, kryesisht lidhet me mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik i cili ka ndodh ne 34 raste deri ne momentin e raportimit kemi po ashtu zgjerimin e rrjetit publik një kontrate aktuale ne te cilën kemi punua vjet ne rrugën “ Washingtoni” dhe këtë vit jemi në fazën e punimit të rrugëve “Abedin Terbeshi”, “Mazllom Lakuci” , “ Vëllezërit Frasheri” këto rruge janë tenderuar vitin e kaluar bëhet fjale për qarshinë e vjetër dhe bëhet fjale për një investim i cili ka qenë në koordinim me ministrinë e kulturës, kemi probleme të theksuara në mirëmbajtje mirëpo jemi duke u munduar të punojmë me aq sa kemi mundësi dhe buxhet, presim këtë vit të prokurohet zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik dhe atëherë do të vazhdojmë me investime në ato lagje të cilat nuk ka pasur më herët.

z. Edmond Dushi : Jam i interesuar ta dije se kush është përgjegjës për ndërrimin e shtyllave të drurit me ato të betonit për shkak se ka pas raste kur ju është kërkuar qytetareve te participojnë në hapjen e gropave apo punëve tjera.

z. Haxhi Sejdiu : Kam një pyetje lidhur me rrugën “ Musa Balijs” është bërë mirëmbajtja me trupa trigled me rastin e ndërrimit te shtyllave të drurit në ato të betonit raporti është për muajin shkurt dhe mars tash jemi ne muajin prill un nuk e di a i kontrolloni punimet kur te kryhen për shkak asgjë nuk ka ndryshuar.

z. Lirika Komoni : Ne mendojmë se raporti është i ceket, për shkak se mungon edhe kosto e këtyre shërbimeve sepse kemi një buxhet të limituar dhe është në interes te dijmë, tjetër sa i përket shtrirjes se linjës në shërbimin publik duam ta dimë se me çfarë kriteri përzgjedhin zonat për shtrirjen e linjës dhe cila është strategjia e punës për vitin në vazhdim, sepse ne kemi kërkuar të jenë prioritet zonat përreth shkollave sidomos zona të stacioni autobusëve dhe stacionet lokale për autobus.

z. Muharrem Musa : Ne fshatin Lugbunar është bere ndryshimi i shtyllave janë hequr te gjitha dritat dhe nuk e dimë se kush është përgjegjës Keds i apo dikush tjetër, po ashtu kemi kërkesë nga fshati Zhub është duke munguar ndriçimi publik qe dy muaj dhe nuk ka asnjë përgjigje për ata banor.

z. Shaban Luma : Dua te them se gjysma e fshatit Cermjan është pa ndriçim publik po ashtu njejt edhe ne fshatin Gregoc dhe një pjese e fshatit Kralan me lejoni te ju përcjell këtë shqetësim te qytetareve sepse edhe gjatë reshjeve te shiut dhe erës ato zona ballafaqohen me ndërprerje te energjisë elektrike dua te dijë se ku është defekti për shkak se po shkaktohen dëme edhe ne biznese te ndryshme familjare.

z. Nikë Hyseni: Dua të ndërlihem me këtë pike të rendit të ditës ku kam një kërkesë nga banoret e fshatit Nec që drejtorja për shërbime publike të investoje në ndërtimin e rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Nec nga rruga kryesore deri në fund saj, njëra nder arsytet është kthimi i nxënësve pasdite nga shkolla sepse detyrohemi ti shoqërojmë nga stacioni i autobusëve që është ne rrugën kryesore ku ka errësirë të madhe.

z. Zef Komani : Rruga “Gjon Nikollë Kazazi” pra rruga kryesore nga lama e druve deri tek ura e tabakut e cila ka qarkullim të madh nuk ka ndriçim, prandaj ju kisha lutur që të bëhet riparimi i dritave pasi që është bërë një degëzim atëherë të bëhen edhe dy tjera dhe të kryhet ky problem.

z. Sadik Hoti : Pasi që jam anëtarë i komitetit për shërbime publike dua të theksoj se është bërë një punë por duhet të bëhet prapë punë tjera, mendoje se shtyllat duhet të ndërrohen enkas për ndriçim publik, nëse e shihni në Rogove kanë mbet në gjysmë shtyllat nuk e di a është kompetencë e Kedsit apo e Drejtorisë, po ashtu afër shkollës “Haxhi Hoti” të cilat i rrezikojnë nxënësit çdo ditë mandej të Gjumnazi “ Hasan Berisha” duhet të bëhet krejtësisht linjë e re, që realisht edhe aty duhet të vendosen shtylla dhe jo vetëm ndriçim në shtyllat e Kedsit, pra këtë që e ceka këtu është edhe propozim i banoreve.

z. Shkumbim Kastrati : Vullneti jone është ti zgjidhim sa ma shpejte këto nevoja qyetetare por kemi problem serioz me mjete financiare për shkak se kodi i mirëmbajtës i ndriçimit publik ka kaluar ne mallra dhe shërbime me qene se mallrat dhe shërbimet sipas ministrisë se financave janë te limituara dhe nuk guxojmë ti tejkalojmë vlera te caktuara atëherë jemi te detyruar brenda mallrave dhe shërbimeve ta ndajmë kodin për këtë arsye jemi te kufizuar ne kuadër te kodit te mirëmbajtës kemi kodin e mirëmbajtjes se gjelbërimit, mirëmbajtjen e auto-rrugëve, mirëmbajtjen e rrugëve dimërore, trajtimin e qeneve endacak, mirëmbajtjen e projekteve te komunës, përpilimin e projekteve te komunës, nuk na lejon ministria e financave kod te veçante për mirëmbajtje. Përgjegjës për vendosjen e shtyllave është Kedsit dhe jo komuna ne nuk kemi asnjë ingjencë për shpërndarjen e rrymës kjo është arsye dhe përgjegjësia e shtyllave, sa i përket fshatit Smolicë është gabim teknik për shkak se kompania ka raportuar se punët janë kryer zakonisht komisioni del pas 2 muaj për mbikëqyrjen e punimeve, sa i përket koston se shpenzimeve te mirëmbajtjes keni drejt nuk e kemi paraqitur koston për shkak se ne raport te shpenzimeve dalin edhe pagesat mund te hyni ne buxhet dhe e shihni sa janë paguar për ndriçim publik gjate këtij viti ku mbi 30.000€ janë paguar për mirëmbajtje këtë vit per te gjitha shërbimet përpos investimeve kapitale ku rruga “Washingtoni” ka kushtuar 50.000 € ndërsa rrugët ne çarshinë e vjetër te cilat do te realizohen sipas standardeve te kërkuara nga ministria e kulturës do te kushtojnë afërsisht 80.000 € për tu përmbyllur po ashtu zonat për rreth shkollave jemi duke i trajtuar me prioritet, ta keni parasysh se kërkesat për zgjerim te rrjetit elektrik janë me mundësi te vogël te realizimit ndërsa te mirëmbajtja kemi hapësirë me shume, ndërsa sa i përket fshatit Cermjan, Gregoc, Kralan dua te ju sqaroj se kedsit është përgjegjës dhe jo ne, komplet distribucioni është përgjegjës, sa i përket fshatit Nec bëhet fjale për rrjet te ri sa i përket riparimit do te realizohet ndërsa sa i përket rrjetit te ri është vështirë i realizueshëm ne këtë faze po ashtu për rrugën “ Gjon Nikollë Kazazi” vlen e njëjta situatë nuk paraqet problem te madhe dhe shumë shpejte do te kryhet, për kërkesën e Sadik Hoti dua te them se ndërrimi i shtyllave te ndriçimit është kompetence e Kedsit.

Pika e 11 e rendit të ditës : Raporti për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Gjakovës .

Kryesuesi: hapi diskutimin lidhur me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës fillimisht fjalën ja japim drejtorit për shërbime publike Shkumbim Kastrati.

z. Shkumbim Kastrati : Për informimin tuaj ne KPF kam raportuar për planin e menaxhimit te mbeturinave ne komunën e Gjakovës këtë vit qëndrojmë me mire se sa viteve te kaluara për shkak se edhe çabratit është mobilizuar me tepër, element tjetër me rendësi është se kemi aktivizuar pjesërisht sektorin për menaxhim te mbeturinave për faktin se sipas planit ky sektor duhet te fuqizohet me 6 persona ndërsa 3 janë te punësuar ne kuadër te menaxhimit te mbeturinave për shkak te limiteve financiare, ne shumë sektorë kemi avancuar kemi me qindra aktivitete te cilat janë ndërmarre me sektorin ne bashkëpunim me çabratin, komunitetin, organizata te huaja dhe me te vërtete është krijuar një atmosferë e garës ne komunitet prandaj vlen te ceket se jemi te punuar me volum te madh ky aktivitet ka pasur sukses te jashtëzakonshëm, Aktivitet tjetër është krijimi i data bazës ne bashkëpunim me GIZIN për kompaninë çabratit janë përfaqësues te gazit dhe komisionet duke punuar ne këtë drejtim. Plani operativ për menaxhimin e mbeturinave parasheh riorganizim gjeneral të

ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave që nënkupton ndërrimin e kontejnerëve rishikimin e taksave për kompani private fillim i implementimit të tijë do të jetë nga data 29.04.2019, një element tjetër brengosësh është se shumica e banesave kolektive që marrin leje të ndërtimit në leje e kanë të përcaktuar qarte vendin për kontejnerin e mbeturinave tani jemi në aksion në kordinim me Drejtorinë për Urbanizëm për banesat të cilat kanë marr leje ndërtimore dhe nuk e kanë implementu planin.

z. Muharrem Musa : Në lidhje me mbledhjen e mbeturinave unë e kam jap mendim edhe me herët, si është e mundur që komuna e Gjakovës të gjej një formë që të futen në inkasim të gjithë qytetaret, do të kishte qene mire që te rregullohet kjo kërkesë sepse do të zgjidhej një problem për të gjithë ata që i hedhin mbeturinat në rrugë. Pra nuk është vetëm mendim i imi sepse kemi pas takime bashkërisht me qytetarët lidhur me këtë temë jemi të mendimit që te gjithë kryefamiljaret të futen në obligim qofte edhe me kushtëzim përmes tatimit të shtëpisë.

znj. Drita Buza : Ne raportin tuaj si drejtor ne vitin 2018 keni thënë se grupi punues ka filluar punën përmes kamerave të instaluara ne kuvendin komunal te Gjakovës me ç ‘rast është duke përgatitur raporti me incizimet e gjithë personave fizik dhe juridik te pa përgjegjshëm ne dëmtimin e ambientit, ndërsa raporti i këtij viti thotë se sektori i menaxhimit të mbeturinave ne bashkëpunim me policinë e Gjakovës ka filluar te shqiptojë gjobat mandatore për qytetaret e papërgjegjshëm që hedhin mbeturina ne hapësirat publike dua ta di sa ka qene efektive kjo metode sepse tash e keni ndryshuar metodën sepse keni themeluar taks forcën, vlen te theksohet se ne kuvendin komunal te Gjakovës është fituar një donacion nga Gizi me 100 kontejner me dimensione te ndryshme te cilët do te vendosen ne institucione te ndryshme pastaj ne vendet ku është e nevojshme, a mund te dimë se ku janë vendosur këta 100 kontejner.

z. Bekim Ermeni : Un pajtona me raportin e Drejtorit, mirëpo kur jemi të objektivat të cilat gjatë vitit 2018 është dashur të punon drejtoria për shërbime publike vendosja e sistemit të taksave dhe tarifave dhe vjeljes se mjeteve, nuk kemi arritje, është dashur të raportohet deri ku kemi arritur, të zonimi nuk kemi arritje duhet ta pranoni, tek shndërrimi i stacionit transfer kemi diskutuar shumë lidhur me këtë teme por nuk kemi rezultat si ekzekutiv, eliminimi i deponive ilegale, i cili kërkohet ne plan te menaxhimit nuk kemi arritje, menaxhimi i mbeturinave inerte kemi hedhje të mbeturinave në tokat bujqësore, ndërtime pa leje objekte askush nuk reagon në këtë aspekt.

Ju duhet të raportoni për planin dhe jo për çështje të vetëdijesimit sepse ajo fushat nuk është e ekzekutivit, por e organizatave jo qeveritare si: Lets do it Kosova, ato kanë qenë edhe në vitet e kaluara 2016-2017 ju duhet të raportoni për pjesën tuaj siç janë: grupet për shqiptimin e gjobave mandatorë, po ashtu duhet të raportoni për planin se deri ku keni arritur.

znj. Hana Zeka : Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave është krijuar që çdo mbetje e mbeturinave të dërgohet në vendin adekuat, nuk kemi mbulueshmeri për grumbullimin e mbeturinave në gjithë komunën e Gjakovës, për arsye se është vetëm një kompani publike, duke u bazuar në një studim të cilin e kemi bërë se gjenerimi i mbeturinave është 100 ton ne ditë jemi bazuar në proporcionin se sa mundet një banor te gjenerojë mbeturina në dite, kompania publike arrin të grumbulloje rreth 60 ton në ditë d.m.th. 30-40 ton që nuk grumbullohen, automatikisht ligji për mbeturina parasheh që çdo komuna ta hartojë planin për të bërë një sistem të mirëfillte të mbeturinave e nënkupton arritjen e shënimit te objektivave strategji adekuate qysh mu realizua kjo sepse na obligon përmes ligjit për mbeturina ligjit për financa publike ligjit të prokurimit që komuna duhet ti inkasoje këto mbetje dhe ti tenderoje. Duhet te dimë çka është duke ndodhur me stacionin transfer për shkak gjendjes se krijuar.

z. Bekim Jupa : Un dua ta sqaroj vetëm një çështje, sepse jeni duke i përzier disa gjëra, ta bëjmë dallimin në mes të sektorit për mbeturina dhe ndërmarrjes K.R.M Qabrati sepse janë dy trupa që funksionojnë ndaras sektori për mbeturina menaxhohet nga Drejtoria për Shërbime Publike ndërsa ndërmarrja çabrati e ka bordin,

ka përfaqësuesit e aksionarëve. Sa i përket stacionit transfer Hana, në vitin 2016 kuvendi komunal ia ka shkëputur punën ndërmarrjes çabratit për stacionin transfer dhe ja ka jap një kompanisë Fantome “ Gjakova Riciklim” e cila edhe sot e kësaj dite e mban të uzurpuar stacionin transfer ku punëtorët e çabratit kane pasur edhe kërcënime fizike për mos kryerjen e punëve të tyre. Po ashtu vlen të theksohet se në Gjakovë funksionojnë edhe 4 kompani ilegale në mbledhjen e mbeturinave në Reken e Keqe në Dushkajë, Reken e mirë dhe në Has, kjo është punë që duhet të merrem ne si asamble që të ia krijojmë kushtet ndërmarrjes Qabrati që ti menaxhoj mbeturinat në të gjithë territorin e Gjakovës. Pra e tha edhe drejtori në hyrje e sqaroj mir se jemi duke shikuar mundësinë me kryetarin që me krijuar fondin që mbeturinat të paguhen nga tatimi vitin e ardhshëm, pra nuk është kosto e vogël por është një kosto që kushton diku rreth 1 milion euro sepse duhet të jetë lindje buxhetore, pra edhe një herë dua të cekim se sektori i mbeturinave dhe qabrati janë dy trupa që funksionojnë për mirëmbajtje. Edhe një fakti duhet të gëzohemi të gjithë se Gjakova është shpallur ndër 4 komunat fituese të grantit për pastërtinë e qytetit, ku asnjëherë me parë Gjakova nuk ka qene me e pastër se tash prej ndërmarrjes çabratit.

Kryetari : Qendra transfer digjet me qellim për te mos pasur mundësi intervenimi, jemi detyruar ta thërrasim FSK-në për te hapur rrugën për shkak se gjithë kohen digjet për te pamundësuar ndërhyrjen e çabratit e gjithë lënda e stacionit transfer është ne prokurori dhe gjitha do te sqarohen kontratat dhe gjitha dokumentet tjera sa i përket pastërtisë ju mund ta shihni se si është gjendja me menaxhim te mbeturinave ne Gjakovë me mire se çdo here tjetër sepse janë gjera që shihen, vlen te theksohet se kamerat janë prokuruar kur te përfundojnë procedurat do te vendosen kamerat, kemi nisur po ashtu me gjobat policia i ka marr formularët dhe qeveria e Kosovës e ka autorizuar policinë, çështje tjetër që duhet ta përmendim është çështja e rrugës për Prizeren po është e vërtete se ka objekte pa leje te cilat janë ndërtuar ne token bujqësore por dilni dhe shikoni a ka filluar ndonjë ndërtim ne mandatin tim, nuk mundem un te ju jap përgjegjësi juve çka ka ndodhe para 10 viteve, ju Bekim keni qen drejtor dhe gjate mandatit tuaj nuk keni ndërmarre asnjë veprim.

z. Shkumbim Kastrati : Lidhur me çështjen e kamerave ne kemi punuar ne këtë drejtim dhe janë identifikuar personat, kompanitë janë marre targat e veturave un si drejtores nuk kam te drejte me i publiku për shkak ligjit për sigurinë e te dhënave personale mirëpo nuk kemi qen te kënaqur vetëm me sistemin e kamerave prandaj është formuar një task force shitesë prej 16 inspektorëve me vendim te kryetarit te komunës përveç këtyre inspektoreve kemi dhe asistencën e policisë, secili inspektor ka raport mujor dhe evidenca lidhur me orarin e punës dhe shqiptimin e gjobave pra ekziston një raport me llogaridhënie për dënimet. Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave është hartuar bashkërisht ky plan nuk është i rastit por është përkrahur edhe nga Demosi ku është bere analize për çdo detaj duke përfshire edhe zonimin janë ndare ne katër zona si parametër është matur popullsia, sipërfaqja, dhe numri objekteve. Detajet te cilat janë këtu i kemi punuar bashkërisht, mundësitë e implementimit nuk janë varur nga ne dëshira ka ekzistuar por kanë qen shumë faktor tjerë që na kane pamundësuar neve ta implementojmë këtë plan. Sa i përket deponive ilegale ju them se 35 janë larguar i keni pa edhe aksionet te cilat janë ndërmarre vlen te ceket se shpërblimi prej 180.000 € është edhe për deponite ilegale që janë larguar si performancë, sa i përket inkasimit duhet te bisedojmë bashkërisht sepse vendimi do te jete i juaji lidhur me formën e inkasimit se a duhet te shkoje përmes kuvendit komunal apo te vazhdoje siç ka qene deri tash, ndërsa për kontejnerët te cilët kanë ardhur nga Gizi janë donacion për përmasim te ofrimit te shërbimeve ne kuadër te kësaj kemi punuar edhe ne ndarjen e mbeturinave kemi marr kontejner për hedhjen e mbeturinave për riciklim por nuk janë duke u respektuar shumica janë shpërndare ne institucione publike mirëpo ka raste që i kemi shpërndare edhe ne ato banesa te cilat kanë hezituuar me i vendos kontejnerët ja kemi imponuar vendosjen aty ku kanë marre leje ndërtimi dhe nuk i kanë vendosur.

z. Muharrem Musa : Unë me herët kërkova të gjendët një model siç e ka komuna e Prizrenit, sepse janë në një inkasim gjithë qytetaret, te ne gjysma e fshatit paguan ndërsa pjesa tjetër nuk paguan, pikërisht personat të cilët janë të punësuar në institucione shtetërore mbeturinat i sjellin dhe i hedhin në qytet, prandaj propozoj të futen të gjithë qytetaret në inkasim dhe zgjidhet ky problem.

znj. Hana Zeka : Për rastin e stacionit transfer është shpall fituesi, pra nga dy kompani të cilat kane aplikuar që janë: Qabrati dhe Gjakova Riciklim, ku fitues është shpallur kompania Gjakova Riciklim mirëpo edhe pse është shpallur fituese nuk kane ardhur ta nënshkruajnë kontratën, po flasin për vitin 2017 sepse operatori ka kërkuar të futen disa kriterë tjerë të cilat për komunën kanë qene të papranueshme.

znj. Edi Puka : Këtu u fol shumë për mbeturina po ashtu për ndërtime dhe gjelbërim, mjafton të dilet në qytet dhe e shihni se çfarë ndërtime keni bërë ku nuk ka vend as për gjelbërim, pra mungojnë hapësirat gjelbëruese, po ashtu mund të shkoni ta vizitoni lumin të ura e tabakut në çfarë gjendje të tmerrshme është, po ashtu gjendja të varrezat e qytetit, pra u bënë po thuaj 2 vite dhe nuk është punuar asgjë dhe mos ta hudhim topin tek e kaluara por të punojmë për të mirën e qytetareve sepse me letra po dalim shumë mirë.

z. Agon Batusha : Sa i përket mbeturinave vlen të ceket se ka forma të ndryshme të mbeturinave nëse marrim modelet ose direktivat e BE-së mjafton ti lexojmë dhe e shohim se çka është mbeturina, nuk janë vetëm ato të cilat krijohen prej bizneseve ose familjeve por ka lloje të ndryshme të mbeturinave, mbjellja e fidanëve nuk është ndonjë arritje e madhe sepse çdo qeveri mbjellë fidanë po ashtu edhe vet qytetarët me raste kanë mbjellë, sa i përket menaxhimit të mbeturinave vlen të theksohet se ka shenja pozitive në këtë drejtim sa i përket pastrimit dhe mirëmbajtjes duhet të fokusohen edhe fshatrat. Unë pajtoj me qëndrimin e kolegut nga opozita Bekim Ermeni sepse në rrugët në drejtim të Prizrenit, Rekës së Keqe, kemi shumë mbeturina të ngurrëta që do të thotë materiale ndërtimore të cilat i hedhin, për këtë arsye duhet marrin masa inspektorati i komunës, pasi që për këto punë paguhen, sa i përket zonave rurale ka raste një shtëpi paguan për mbeturina ndërsa në 3 shtëpi tjerë e mbledhin, pra qka po duhet të them është se nuk mund të trajtohet një market i vogël njëjtë sikurse një super-market, apo një fabrike me një zejtar nuk është në rregull të aplikohen të njëjtat tarifa. Pra këtu nuk po e fajësojë vetëm komunën por duhet që të ulemi bashkërisht të gjithë të punojmë por çdo kritik e mirë mendoj se është këshillë e mirë

znj. Mimoza Shala : E kam potencuar edhe herëve tjera kur është fjala për ndonjë kauzë të mirë unë e përkrahi pavarësisht kush e inicion unë do ti përgjigjem, sepse në të mirat e përbashkëta përfitojnë të gjithë së pari fëmijët e mi dhe familja, e me pas edhe qytetarët e tjerë. Unë mendoj se nuk ka lidhje fare këtu pozitë apo opozitë por kur është shqetësuese normal se e potencoi, ajo që e përmenden Agoni dhe Bekim Ermeni rruga Gjakovë - Prizren është shqetësuese gjendja e rrugëve, tokë me pjellore nuk e di që ka në Gjakovë dhe vetëm shkoni dhe vizitoni se sa betoni është hedhur aty dhe kjo është diçka që ekziston dhe neve po na pengon dhe për këtë duhet të gjinden personat që po e shkatërrojnë atë tokë dhe të dënohen.

Pika e 12 e rendit të ditës : Të ndryshme

Kryesuesi : E hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z. Rrok Luli : Fillimisht dua të ju falënderojë gjithëve për pritjen që na keni bërë mua dhe Xhavitit, unë dua të elaborojë këtë çështjen e qëndrimeve të pozitës dhe opozitës, sepse secila palë ka qëndrimet e saj dhe militantet i përkrahin, unë dua që në këtë asamble të kemi njerëz të cilët e pranojnë realitetin gjatë diskutimit siç ishte rasti i Muharrem Musës, të disa nga pikat e rendit të ditës sidomos ato të fundit e pash se kemi pozite dhe opozite, diçka që dua të theksoj është që shumica janë në dijeni se unë nuk jam pjesë e grupacioneve në parti politike dhe në shumë raste kur kam votuar edhe pse nuk më ka pëlqyer një pikë kam dalë në foltore dhe e kam cek se po e votoj për shkak të grupit parlamentar, por nuk mendoj se është mirë për qytetarin, e di që duhet respektuar vullnetin e shumicës 51%, por krejt qka dua të them është se duhet ta pranojmë realitetin edhe pozita edhe opozita kur punohet dhe atëherë kur nuk punohet, pra kështu edhe qytetari pastaj e beson se vërtetë qenka mirë. Sa i përket opozitës në gjitha diskutimet unë mund të them se shumicën e rasteve pajtoj, për shkak se kritikën e opozitës janë në të mirë të ekzekutivit.

znj. Diana Qarkagjia : Mendova se do të jetë prezent edhe Drejtori i Arsimit të diskutojmë lidhur me një migrim të heshtur i cili po ndodh në shkollat tona, kemi informata se ka lëvizje të nxënësve në klasa si në zonat urbane po ashtu edhe ato rurale, ndoshta do të kishte qenë mire që mbledhjen e radhës drejtori të raportoje se ku ka lëvizje me të madhe dhe ku po shkojnë këta fëmijë.

znj. Mimoza Shala : Unë e kam një pyetje drejtuar kryetarit nga një kategori e veçantë e shoqërisë tonë invalidët e luftës se fundit të cilët kanë kërkuar ta pyes kryetarin a ka ndonjë plane për këtë kategori të cilët nuk kanë banim, dhe të gjithë jemi dëshmitare se banesat sociale keqpërdoren nga njerëzit të cilët i kanë uzurpuar edhe pse janë me kushte të mira ekonomike, ndërsa një kategori e tilla të mbesin keq në këtë formë nuk është e arsyeshme prandaj dua të dije nga kryetari se çfarë plani ka për shkak se shumica komunave kanë bërë zgjidhje për familje të dëshmoreve apo invalid të UÇK-së .

z. Agon Batusha: Unë dua të i njoftoj këtu përmes televizionit se nesër është një protestë kundër Kryeprokurorit Lumezi, e di që shumicës këtu nuk po ju pëlqen mirëpo, unë kam drejt përmes foltores me bë thirrje sepse në fund qytetarët po ballafaqohen me këto probleme.

z. Xhavit Alija: Unë dëshiroj të ju përsëris të gjithëve dhe të ju falënderoj për pritjen, e di që duhet të ballafaqohemi pozitivisht dhe opozitivisht nganjëherë, mirëpo e kam një pyetje lidhur me Bekim Ermenin ish drejtorin e bujqësisë se a jeni duke iu gëzuar autostradës dhe a jeni pro me dal me thanë ndonjë fjalë apo me kundërshtua ata që janë kundër autostradës sepse nuk iu kam n ‘dëgjuar me ndonjë deklaratë.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u pafshim në takimet e radhës .

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 14:00.

Procesmbajtës

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit

z. Anton Shala